



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGIISË

**VENDIM**

**Nr. 161 Datë 07.12.2012**

**MBI**

**SHQYRTIMIN E APLIKIMEVE TË KESH SH.A, TEC VLORE SH.A, OST SH.A, CEZ SHPËRNDARJE SH.A, ULËZ-SHKOPET SH.A, BISTRICA 1, 2 SH.A PËR PËRDITËSIMIN E TARIFAVE TË GJENERIMIT, TË FURNIZIMIT PUBLIK ME SHUMICË, TË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT, TË SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES DHE FURNIZIMIT ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KONSUMATORËT TARIFORË PËR PERIUdhËN E TRETË RREGULLATORE (2012-2014)**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.12.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërive KESH sh.a, TEC Vlore sh.a, OST sh.a, CEZ Shpërndarje sh.a, Ulëz-Shkopet sh.a., Bistrica 1, 2 sh.a për përditësimin e tarifave të gjenerimit, të furnizimit publik me shumicë, të shërbimit të transmetimit, të shërbimit të shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për Periudhën e Tretë Rregullatore (2012-2014) sipas Metodologjive përkatëse,

**Vendosi :**

1. Të lërë në fuqi tarifat e miratuara nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, me vendimin nr. 144, date 07.12.2001 “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a, për Periudhën e Tretë Rregullatore”, vendimin nr. 87, date 29.06.2012, “Për rishikimin e tarifës për Furnizuesin Publik me Shumicë për Periudhën e Tretë Rregullatore për akomodimin e efekteve financiare të vendimit nr. 80 datë 15.06.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s”, vendimin nr. 151, date 7.12.2011 “Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga TEC Vlora sh.a tek FPSH, për Periudhën e Tretë Rregullatore”, vendimin nr. 152, date 7.12.2011

“Per percaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Bistrica 1,2 sh.a. për Periudhën e Tretë Rregullatore”, vendimin nr. 153, datë 7.12.2011 “Per percaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Lanabregas sh.a. për Periudhën e Tretë Rregullatore”, vendimin nr. 154, datë 7.12.2011 “Per percaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Ulez Shkopet sh.a. për Periudhën e Tretë Rregullatore”, vendimin nr. 146, datë 7.12.2012 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për Periudhën e Tretë Rregullatore”, vendimeve nr.147, datë 07.12.2011 “Per percaktimin e tarifës së shpërndarjes të energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014, vendimin nr.148 datë 07.12.2011 “Per percaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën e tretë rregullatore”, vendimi nr.149 datë 07.12.2012 “Per percaktimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitin 2012”, vendimi nr. 150 datë 07.12.2012 “Per percaktimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet egzistues me fuqi të instaluar deri në 10 MW për vitin 2012”.

2. Bordi i Komisionerëve të ERE-s, do të përditësojë vendimet e parashtruara në pikën 1 të këtij vendimi, brenda datës 30 Qershor 2012.
3. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesit për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Sokol RAMADANI**